

VENDIM
Nr. 470, datë 18.7.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË PORTIT TË JAHTVE NË QYTETIN E
DURRËSIT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE
KONKURRUESE, QË I JEPET SUBJEKTIT “I.S.D.C.”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës BOT (ndërtim-shfrytëzim dhe transferim në pronësi të shtetit), të ndërtimit dhe shfrytëzimit të portit të jahteve në qytetin e Durrësit është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Miratimin e bonusit prej 7% të pikëve për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet subjektit “I.S.D.C.”.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha